



# MANUAL I AKTIVIZIMIT APLIKACIONI I RI

Union Bank Business








Union Bank

# Një eksperiencë e re digjitale po vjen në Union Bank.

Union Bank ju prezanton me aplikacionin e ri, tani me një pamje më moderne, përdorim më të lehtë dhe hyrje më të sigurt. E gjithë platforma është përmirësuar për të ofruar shërbim të shpejtë dhe efikas!

## Çfarë do të ndryshojë?

-  Design modern
-  Eksperiencë përdorimi e thjeshtuar
-  Teknologji e re dhe e përmirësuar për sigurinë e aplikacionit
-  Funksione të reja
-  Dy platforma të ndara, për Individë dhe për Biznese

## Ku mund ta shkarkoni?

App Store ose Play Store




**“Union Bank Live”** për individ ose **“Union Bank Business”** për Biznes.

## Na kontaktoni:

E-mail: [callcenter@unionbank.al](mailto:callcenter@unionbank.al)

Linja e Kujdesit ndaj Klientit (Contact Center)

 +355 4 238 91 11

Për më shumë informacione: <https://www.unionbank.al/>


## Informacion i rëndësishëm

Për të përfunduar me sukses aktivizimin, sigurohuni që:

- ✓ Mjeti juaj i identifikimit të jetë i vlefshëm, nëse ka skaduar paraqituni në degë për t'a përditësuar atë.
- ✓ Aktivizoni elementet biometrike të sigurisë në pajisjen tuaj (Face ID, Fingerprint).
- ✓ Gjuha e pajisjes tuaj të jetë e vendosur në anglisht ose shqip.

# 1. Shkarkoni aplikacionin e ri

Si përdorues Biznes, shkarkoni **Union Bank Business**.





# 2. Aktivizo aplikacionin

Për të nisur aktivizimin, klikoni butonin **“Vazhdo”**.



### 3. Vazhdo

Klikoni **“Vazhdo”** nëse jeni përdorues ekzistues.



### 4. Emri i përdoruesit

Vendosni emrin e përdoruesit ekzistues dhe klikoni butonin **“Vazhdo”**.

## 5. Vendosni kodin e verifikimit

Kodi i verifikimit do t'ju dërgohet në email, ju lutemi kontrolloni email-in tuaj.



## 6. Vendosni kodin nga email-i

Vendosni kodin 6-shifror të verifikimit nga emaili dhe klikoni butonin **“Verifiko”**.






## 7. Vendosni kodin e verifikimit me SMS

Vendosni kodin 6-shifror të verifikimit dërguar në numrin tuaj të regjistruar në bankë dhe klikoni butonin **“Verifiko”**.

## 8. Termat dhe Kushtet

Klikoni katrorin **“Kam shqyrtuar me kujdes...”** dhe **“Vazhdoni”** në hapin e radhës.






## 9. Skanoni ID ose Pasaportën

Filloni procesin e skanimit të dokumentit.



## 10. Vazhdoni me skanimin

Vazhdoni me skanimin e pjesës mbrapa të dokumentit.



## 11. Verifikimi me sukses

Pasi janë gjeneruar informacionet personale, klikoni butonin **“Vazhdo”** për hapin e rradhës.





## 12. Skanoni fytyrën

Poziciononi fytyrën sipas kërkesave të skanimit derisa rrethi të bëhet jeshil.

## 13. Verifikimi përmes kamerës me sukses

Identiteti juaj u verifikua me sukses. Klikoni butonin **“Vazhdo”** për më tej.





## 14. Ruajtja e dokumentit në bankë

Nëse dëshironi që dokumenti i skanuar të ruhet në bankë për referencë në të ardhmen, klikoni **“Po”** dhe nëse nuk dëshironi, klikoni **“Jo”**.

## 15. Verifikimi përfundoi

Të dhënat biometrike u verifikuan me sukses.



## 16. Aktivizimi me sukses

Tashmë keni aktivizuar aplikacionin e ri ku mund të kryeni çdo shërbim digjital bankar

**UNION BANK  
JU URON EKSPERIENCË  
TË KËNDSHME!**